



# RELACION TEKNIK

## Mbi

### Prjektin e Restaurimit

### "Kisha e Shën Mëhillit\_Mingul", Gjirokastër

Punoi: Ark. Arbjona BALA

Ing. Zaim LILA

MIRATOHET

PËR K.K.T.K.M.

SEKRETARI

Eugen KALLFANI

TIRANË Maj 2022



**PËRMBAJTJA:**

1. VENDNDODHJA.....	2
2. ANALIZA HISTORIKO –ARKITEKTONIKE.....	3
- Të Dhënat Historike.....	3
- Analiza Arkitektonike.....	3
- Bibliografia.....	4
- Fazat e ndërtimit të kishës.....	5
- Rilevime të vjetra nga Arkivi i IKTK.....	7
- Foto të vjetra të viteve 1966-67.....	10
3. NDËRHÝRJET NDËR VITE.....	14
4. GJENDJA E KONSERVIMIT.....	16
5. NDËRHÝRJET RESTAURUESE TË PARASHIKUARA.....	30

## Vendndodhja:

Kisha e Shën Mehillit ndodhet në fshatin Mingul, rreth 15 km nga qyteti i Gjirokastrës.

Kisha është e pozicionuar në qender te fshatit dhe përdoret ende nga komuniteti lokal.




Fig 1 “Foto ajrore, pozicionimi i fshatit Mingul”




Fig 2 "Foto ajrore e Kishës se Shën Mëhillit\_Mingul"

## ANALIZA HISTORIKO – ARKITEKTIONIKE

Kisha e Shën Mëhillit në Mingul është pasuri kulturore, me status Monument Kulture Kategoria e I-rë, nga Rektorati i Universitetit Shtetëror i Tiranës Nr.6 – datë 15/01/1963.

Kisha e Shën Mëhillit në Mingul përbëhet nga naosi, narteksi, hajati dhe një ambient i shtuar në anën perëndimore.

Naosi është i tipit bazilikal me kupolë, me përmasa të brendshme 8.20 m x 7.80 m. Dy rradhë kollonash me bazë katrore mbajnë harkadat gjatësore që ndajnë nefet nga njeri tjetri. Nefi qendror, me i gjerë dhe më i lartë nga nefet anësore, mbulohet me qemer cilindrik, i cili ka një shkallëzim dhe një ndërprerje nga bërthama e mbuluar me kupolë mbi një tambur të lartë.

Meqenëse baza e bërthamës së kupolës nuk është katrore, për ta krijuar atë, janë ndërtuar dhe dy harqe shtesë në drejtimin gjatësor. Kollonat lidhen me muret përbri

me harqe, duke krijuar në këtë mënyrë në nefet anësore bërthama katrore të mbuluara me kësula sferike.

Ambienti i altarit, i ndarë nga një ikonostas druri, përmban apsidën e bemës dhe konkën e protezisit të nxjerra jashtë, si dhe dy nikel pér diakonikonin. Pjesët e ambientit të altarit janë të mbuluara me qemere.

Naosi lidhet me narteksin në anën perëndimore me tri hapësira.

Narteksi ka të njëjtin ndërtim planimetrik dhe struktural.

Kisha është e ndriçuar nga dritare të hapura në murin jugor dhe verior. Dyshemeja është e shtruar me pllaka guri të bardha.

Hyrjen në anën jugore të naosit e paraprin një hajat i hapur, i ndertuar në një kohë më të vonë. Po kështu në anën perëndimore të narteksit është shtuar një ambient i ri.

Në pamjen e jashtme bien në sy proporcionet e ulëta, mbizotermi i masës së gjerë të çatisë me pllaka guri mbi atë të muraturës. Ndërprerja e çatisë nga kupola në pjesën qendrore, nuk arrin të dobësoje këtë përshtypje. Tamburi ngrihet mbi një bazament, ana veriore dhe jugore e të cilit janë përpunuar në formë frontonesh trekëndëshe, të cilët janë projektimi i harqeve shtesë pér krijimin e bërthamës katrore të kupolës.

Kisha është ndërtuar me gurë shtufi, të vendosur në menyrë jo të rregullt në muraturë dhe është e zhveshur krejtesisht nga përpunimi dekorativ. Tamburi cilindrik i suvatuar, si dhe apsidat janë gjithashtu të pa dekoruara.

Kompozimi planimetrik dhe hapësinor i interierit, ku ende ruhen elemente të tilla si kupola mbi tambur, ndërsa futen konceptime të tjera, si copëtimi i hapësirës së nefeve në bërthama të veçanta, si dhe trajtimi i jashtëm i varfër, janë karakteristika të ndërtimeve të fillimit të shek. XVIII, kohë në të cilën jemi të prirur të datojmë këtë kishë.

### **Referencat - Bibliografia**


*A. Meksi – P. Thomo, Arkitektura pasbizantine ne Shqiperi, Monumentet 19, 1980*

*P. thomo, - Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Tiranë, 1998, f. 147-148*


## FAZAT E NDËRTIMIT TË KISHËS

Duke iu referuar përshkrimeve bibliografike përsa i përket datimit të mundshëm, fazat e ndërtimit të Kishës së Shën Mëhillit në Mingul dhe analizave në objekt, të teknikes së ndërtimit, gjykojmë që kisha është ndërtuar në faza të ndryshme si më poshtë vijojnë:


**FAZA I**




**FAZA II**



***FAZA III***



***FAZA IV***



**RILEVIME TË MARRA NGA ARKIVI I IKTK-SË (viti 1968)**




Fig 3 "Planimetria e Kishës se Shën Mëhillit Mingul"







Fig 4 "Prerje gjatësore e Kishës së Shën Mëhillit Mingul"

Projekt Restaurimi- "Kisha e Shën Mëhillit\_Mingul", Gjirokastër





*Fig 7 “Fasada veriore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul”*



*Fig 8 “Fasada lindore e Kishës së Shën Mëhillit Mingul”*

FOTO TË VITEVE 1966-67 TË MARRA NGA ARKIVA E IKTK-së




Fig 9 "Pamje të jashtme të Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 10 "Pamje të jashtme e Këmbanares së Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 11 "Pamje të jashtme e Fasadës Veriore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 12 "Pamje të jashtme e Fasadës Veriore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 13 "Pamje të jashtme e Fasadës Jugore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 14 "Pamje të jashtme e Fasadës Jugore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"




Fig 15 "Elemente arkitektonit ne fasaden e jashtme te Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"




Fig 16 "Pamje të brendshme të Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"

## NDËRHYRJET NDËR VITE

Nga shqyrtimi i dosjes së monumentit në Arkivin e IKTK-së, përveç rilevimeve të vjetra të vitit 1968, është i dokumentuar dhe një relacion inspektimi i vitit 1979, në të cilin thuhet se kisha e Shën Mëhillit paraqet problematika si më poshtë vijojnë:

- Çarje në kupola dhe në qemeret e gurit
- Çarje gjatësore në kulmin e qemerit të nefit qendror e cila shkon tej për tej afer tamburit
- Prezencë lagështie e madhe në nefin e majtë të apsidës
- Në Naos ruan pikture murale nefi qendror dhe nefi i majtë, ndërsa nefi i djathtë është i lyer me gëlqere
- Në Narteks ka prezencë lagështie të madhe sidomos në faqet anësore

- Nga të dhënat e kujdestarit të kishës rezulton se nga renia e një dege të Rrapit të madh përbri kishës, është prishur një pjesë e çatisë së kishës.
- Riparimi i bërë nga Ateljeja e Tiranës ka qenë sipërfaqësor.

I N F O R M A C I O N

KISHA E SHËN MEHILLIT PSHATI MINGUL RRETHI GJIROKASTER

Kontrolluer date 9.2.1979


Ruan nje ikonostas druri te zdhendur me gjatesi 7.65m. lartesi 4.5 m. ka 31 ikoma ( ka edhe nje vita 1780) dhe 12 punime metalike te cilesuara ne kontrate, si edhe 2 rroba drifti . Kisha ruam afreske ne tere sipërfaqen e sajë .

Përvshkrimi i gjendjes jasht absides qemeri dhe vete kupola ka qarje . Të dy sjetet kane lageshtire.Nefi majte mbi kollonen ka qarje 7 - 10 cm. qe shkodra sfér tamburit. Nga befi majte jashtë ka nje (lageshtire te madhe) .Kupola mbi nefin e majte ka qarje qemeri qe shkond deri në 1/2 e kupoles . Ngj Nëos tavani forme harku ka qarje tej per tej ne mes . Ngj Nartekë ka lageshti te madhe sidomos facet anësore . Ruan piktura pjesa cendrore, nefi majte i apsides nefi i djethët e shtëtë lyer me gelçare .

Nga te thenat e kujdesatrit del se nje dege e nefit te madhe qe eshte përbri kishës ka rene mbi qati qe ka prishur atë . Riparimi i bere nga Ateljeja e Tiranës ka cënë i percipet e na përgjegjesi . Kisha ka nevëje urgjente per ndrim qati qe ragullim dritaresh .

K O M I S I O N I

SPIRO LACKA



MATI BABA

ODISE GURI




Fig 17 "Relacion sherbimi I vitit 1979 në Kishën e Shën Mëhillit\_Mingul"

## GJENDJA E KONSERVIMIT

Nga inspektimi i ralizuar nga specialistët e IKTK-së në terren, u konstatua se kisha e Shën Mëhillit paraqet probleme të shumta konstruktive. Në brendësi të kishës janë të pranishme çarje të shumta në strukturën e kupolave dhe qemerëve prej guri të cilat në pjesën më të madhe të sipërfaqes së tyre janë të pikturuara. U konstatua prezencë lagështie në pjesën e sipërme të tyre si pasojë e kapilaritetit të ujërave sipërfaqësore që vijnë nga mbulesa e çatisë. Gjithashtu vërehet degradim dhe shkëputje e suvasë, dëmtim i dyshemesë me pllaka guri, degradim i karrikeve prej druri, dyereve dhe dritareve si dhe të gjithë elementëve drusorë në interier. Ambjenti i narteksit, edhe pse i ndërtuar më vonë dhe i pa pikturuar në brendësi të tij, paraqet dëmtime edhe me të shumta si çarje të thella në muraturë dhe në qemere. Përsa i përket pjesës së hajatit ai paraqitet tëresisht i rënë me përashtim të kolonave të gurit të cilat ruhen pjesërisht në kuoten e poshtme të tyre. Në mënyrë të përbledhur problematikat paraqiten si më poshtë:

- Ambjent i shtuar më vonë volumit të kishës në faqen perëndimore të Narteksit, i cili aktualisht ruhet në formën e rrënojes (për të cilin nuk kemi një datim të saktë të periudhës së ndërtimit, por nga gojëdhënët e komunitetit të zones, mendohet të jetë ndërtuar në periudhën e Komunizmit dhe përdorej si magazine nga kooperativa).
- Presencë bimësi e ulët dhe e lartë e mbirë në brendësi të rrenojave, shumë pranë fakes perëndimore të Narteksit.
- Rënie pjesore e hajatit në faqen jugorë të kishës, nga prej mundësohet dhe aksesi për në kishë, i cili mendohet të ketë rënë brënda afatit kohor të viteve 1968 – 1979, pasi në fotot e vitit 1966-1967 rezulton të jetë i plotë, ndërsa në relacionin e vitit 1979, hartuar nga specialistët e Institutut të Monumenteve të Kulturës, shprehen se një pjesë e kishës është dëmtuar bashkë me çatinë e saj, si pasojë e shkëputjes së një dege të Rrapit të madh ndodhur në afërsi të kishës.
- Ngritje e nivelit të dherave përreth kishës ndër vite, të cilat kanë shkaktuar depërtimin e lagështisë në brendësi të muraturës, në bazamentin e poshtëm të saj, duke shkaktuar shkëputjen e suvasë bashkë me pikturën murale. Fakti që terreni në fasadën lindore dhe veriore me kalimin e viteve është ngritur, e dëshmon porta e murosur në fasadën veriore e cila aktualisht ruhet në lartësinë prej 1.2 m.

- Çarje të thella në stukturat e kurbëzuara (të pikturuara ose jo), dhe prezencë lagështie në to, të cilat vijnë nga kapilariteti i ujërave sipërfaqësore të çatisë me rrasha guri, c'ka dëshmon se rrasat e gurit kanë lëvizur ose janë dëmtuar.
- Çarje gjatësore në të gjithë qemerin e nefit qendror të kishës.
- Degradim i tirantëve të drurit, të vendosur në qemerin e nefit qentror të Naosit dhe të vetmit në kishë.
- Çarje gjatësore rreth 1.5 cm në muraturën e jashtme të fasadës lindore të kishës.
- Degradim i llaçit lidhës në muraturën e kishës.
- Çarje të shumta në muraturën perëndimore të Narteksit, mbyllje e dritareve në këtë krahë si pasojë e ndërtimit të ambjentit të shtuar më vonë kishës.
- Presencë patinë biologjike në muraturën e jashtme të kishës përfshirë edhe Këmbanaren.
- Degradim i elementëve drusorë të dritareve dhe deres së Narteksit.
- Degradim i arkitrarëve të drurit të dyerive dhe dritare.
- Presencë ndryshku në kangellat metalike të dritareve.
- Derë duralimini në hyrje të kishës në Naos (ndërhyrje e gabuar).
- Demtim i suvasë pa pikturë murale (në dukje), në brendësi të kishës, si në Naos ashtu edhe në Narteks, si pasojë e depërtimit të lagështisë nga sipër por edhe në fasadë nga mungesa e dritareve.
- Dëmtim i karrikeve prej druri të kishës, të cilat aktualisht ruajnë vetëm disa elementë të tyre tepër të degraduar.
- Shtresë betoni në bazamentin e poshtëm të karrikeve të kishës (ndërhyrje e gabuar)
- Degradim i dyshemese së drurit poshtë karrikeve të kishës.
- Demtim i shtresës me pllaka guri në Naos (mungesë materiali, dëmtim i llaçit lidhës)
- Shtresë me pllaka majolike në Narteks (ndërhyrje e gabuar).

- Demtim i shtresës me pllaka guri të hajatit.
- Prishje/rënie e xokolit prej mur guri në hajat (konstatohet prezenca e tij nga gjurma dyshemesë me pllaka guri).
- Renie e një fragmenti të murit rrethues të kishës në krahun perëndimor të saj.

#### FOTO TË GJENDJES EKZISTUESE (viti 2022)




Fig 18 "Pamje e Kambanares së Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"




Fig 19 "Fasada lindore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 20 "Fasada jugore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"




Fig 21 "Fasada jugore e Kishës së Shën Mëhillit Mingul"



Fig 22 "Fasada jugore e Kishës së Shën Mëhillit Mingul"




Fig 23 "Pamje e portës hyrëse e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 24 "Pamje e hajatit te rrrenuar ne faqen jugore te Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 25 "Fasada veriore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



*Fig 26 “Fasada veriore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul”*



*Fig 27 “Fasada veriore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul”*



Fig 28 "Fasada perendimore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"




Fig 29 "Fasada perendimore e Kishës së Shën Mëhillit\_Mingul"



Fig 30 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Verior)"



Fig 31 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Verior)"



Fig 32 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Verior)"




Fig 33 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Verior)"



Fig 34 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Verior)"




Fig 35 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"




Fig 36 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"




Fig 37 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"



Fig 38 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"



Fig 39 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"



Fig 40 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"




Fig 41 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"




Fig 42 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"



Fig 43 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Qendror)"




Fig 44 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"



Fig 45 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"




Fig 46 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"




Fig 47 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"




Fig 48 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"




Fig 49 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"



Fig 50 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"



Fig 51 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"




Fig 52 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"




Fig 53 "Pamje e brendshme e Naosit (Nefi Jugor)"




Fig 54 "Pamje e brendshme e Narteksit"




Fig 55 "Pamje e brendshme e Narteksit"




Fig 56 "Pamje e brendshme e Narteksit"



Fig 57 "Pamje e brendshme e Narteksit"



Fig 58 "Pamje e brendshme e Narteksit"



Fig 59 "Pamje e brendshme e Narteksit"

## NDËRHYRJET RESTAURUESE TË PARASHIKUARA

Duke parë dhe vlerësuar situatën specialistët propozojnë ndërhyrjet si më poshtë:

- Çmontim i rrënojave të shtesës së mëvonëshme ngjitur me kishën (Restaurim Clirues).
- Ulje e kuotës së dherave përreth kishës/ ndërtim trotuar perimetral dhe kunetë për disiplinimin dhe largimin e ujërave sipërfaqësore.
- Puntelim i qemerëve dhe kupolave nga brënda, mbrojtja e sipërfaqeve me pikturë murale me sfunjjer dhe letër japoneze.
- Çmontim i çatisë me rrasa guri, zbritje, sistemim, seleksionim, pastrim i rrasave të gurit dhe ripërdorim i tyre.
- Pastrim i kupolave/qemerëve nga mbushja e dherave deri në zbulimin e plotë të tyre.
- Pastrim i qemerëve dhe kupolave nga mbushja dhe llaçi i degraduar.
- Fugatim/ Injektim i çarjeve në kupola/qemere, qepje e konstukzionit të tyre nëse çarjet janë më të mëdha se 5 cm.
- Shtresë llaçi horasan sipër kupolave/qemerëve për hidroizolimin e tyre.
- Restaurim i tirantëve të drurit në Naos/ zëvendësim i tirantëve të degraduar me tirantë të rinj prej dru lisi të stazhonuar me dimensione të ngajshme me ekzistuesët.
- Mbushje përsipër strukturave të kurbëzuar me mbushje të lehtësuar (e ngajshme me teknikën origjinale).
- Montim, plotësim (60%) rrasa guri mbi struktura të kurbezuara.
- Fugatim/injektim i muraturës në të gjithe sipërfaqen e jashtme të kishës.
- Ringritje e hajatit të rënë sipas gjurmëve ekzistuese në objekt dhe rilevimeve të dokumentimeve të vjetra.
- Çmontim i dyreve dhe dritareve të degraduara ose të pa përshtatshme (dera duralumini në hyrje).
- Prishje shtresë betoni poshtë gjurmëve të karrikeve të drurit.
- Çmontim i elementëve të karrikeve të drurit dhe i bazamentit të poshtëm të tyre të cilat janë teje të amortizuara.
- Çmontim i shtresës me pllaka majolike në narteks, ndertim shtresë me pllaka guri të skuadruara.
- Konsolidim/ Restaurim i Pikturës Murale.

- Riparim, suvatimi dhe retukim i pjesëve të dëmtuara të suvasë me llaç gëlqere (sipërfaqet pa pikturë), sherbetosje e bojatisje me gëlqere.
- F.V. dyer dritare druri si ekzistueset.
- F.V. karrike druri kishe si ekzistueset.
- Restaurim breza dhe arkitra druri.
- Lyerje me antimol, vaj lini dhe boje vaji i tanteve/brezave të drurit.
- Pastrim dhe lyerje me boje vaji i elementeve metalike.

**PUNOI:** Ark. Arbjona BALA

**Ing. Zaim LILA**